

**REZYME MBI TEZËN E NIVELIT MASTER NË POLITIKË
NDËRKOMBËTARE**

**ROLI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE AKTORËVE TJERË NË
LEHTËSIMIN E DIALOGUT KOSOVË – SERBI**

NGA

FLORENT

THAQI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

Prishtinë

Qershor, 2022

ROLI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE AKTORËVE TJERË NË LEHTËSIMIN E DIALOGUT KOSOVË – SERBI

Mentor: Prof.Dr. Ibrahim Gashi

Raportet mes Kosovës dhe Serbisë në periudha të ndryshme kohore janë karakterizuar dhe përcjellë me tensione të cilat kanë evoluar edhe në luftë mes tyre. Si rezultat i dhunës dhe krimeve të shtetit të Serbisë ndaj popullësisë civile shqiptare në Kosovë, në Kosovë ka ndodhur intervenimi i NATO-s, i përcjellë më vonë edhe nga vendosja e pranisë civile dhe ushtarake ndërkombëtare në Kosovë me qëllim ruatjen e paqës dhe ndërtimin e Kosovës.

Edhe pas luftës së Kosovës raportet me Serbinë nuk janë përcjellë me ndonjë përmirësim, pasi që Serbia gjithmonë ka pretenduar se Kosova është pjesë e saj, duke u munduar në forma të ndryshme të pengojë zhvillimin e Kosovës. Pas publikimit të dokumentit “Standardet para statusit”, kishin filluar bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë të njohura si bisedimet e Vjenës me qëllim të arritjes së zgjidhjes së statusit të Kosovës. Këto bisedime ishin ndërmjetësuar nga bashkësia ndërkombëtare si rezultat i së cilave ishte paraqitur dokumenti Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës, i njohur si Plani i Ahtisaarit. Me gjithë pjesëmarrjen e Serbisë në këto bisedime, ajo nuk kishte pranuar këtë dokument, gjë që kishte penguar aprovimin e këtij dokumenti në KS të OKB-së.

Roli i organizatave ndërkombëtare dhe aktorëve tjerë në negocimin për arritjen e marrëveshjes për njohje reciproke mes Kosovës dhe Serbisë, është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Duke filluar nga bisedimet e Vjenës, si rezultat i të cilave u arrit paraqitja e Propozimit Gjithëpërfshirës dhe paraqitja e pavarësisë së Kosovës. Edhe procesi i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë i ndërmjetësuar nga BE paraqet mundësi për arritjen e njohjes reciproke mes Kosovës dhe Serbisë. Mirëpo për shkak të realitetit, faktit të mos njohjes së Kosovës nga 5 shtetet anëtare të BE si dhe për shkak të rrethanave të përdorimit të shkopit dhe karrocës nga BE ndaj Serbisë si rezultat i lojës së saj mes Lindjes dhe Perëndimit, ka mundësuar vonesën për arritjen e kësaj marrëveshje.

Strukturalisht ky punimi është i organizuar në pesë kapituj, ku secili prej tyre përmban edhe nën tema të shtjelluara përbrenda kapitullit përkatës. Qellimi i punimit është shtjellimi i rolit të organizatave ndërkombëtare në lehtësimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Kapitulli i parë- E gjithë struktura e këtij punimi do të rregullohet në atë mënyrë që pak a shumë të kuptojmë rolin e organizatave ndërkombëtare dhe format e negocimit, e që i referohet kapitullit apo pjesës së parë të punimi me një spjegim bazë të temës që paraqet një njoftim të lexuesit mbi aspektin teorik të organizatave ndërkombëtare dhe negocimit.

Kapitulli i dytë- do të jetë i fokusuar më shumë në atë së cilat janë raportet e Kosovës dhe Serbis që nga shpërbërja e Jugosllavisë e deri në shpalljen e Pavarsis së Kosovës.

Kapitulli i tretë dhe ai i katërt- do të fokusohet në kontekstin historik të fillimit të bisedimeve Kosovë – Serbi, arritja e marrëveshjeve të para e deri të implementimi i tyre në praktik.

Kapitulli i pestë- fokusohet mbi rolin e organizatave ndërkombëtare dhe aktorëve tjerë në negocimin për arritjen e marrëveshjes për njohje reciproke mes Kosovës dhe Serbisë

Shtjellimi i temës na bie në përfundimin e pashmangshëm që organizatat ndërkombëtare pa shmangshëm kanë një rol crucial në mundësimin e arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse mes Kosovës dhe Serbisë, duhet pershendetuar dhe uruar të vazhdojë deri në fund “harmonia” dhe bashkëpunimi mes dy faktoreve me të rendësishem në këtë proces ShBA dhe BE. Por, skajshmërisht është shumë e rendësishme dhe që duhet t’u kemi të qartë, është se, çfarëdo marrëveshje që të arrijnë Kosova dhe Serbia për të përfunduar procesin e normalizimit të marrëdhënieve, midis tyre, ajo duhet të jetë një marrëveshje ligjore detyruese që do t’u mundësojë të dyja palëve të ecin përpara në rrugën e integritimit dhe të pranimit në BE pa lënë qeshtje të hapua mes vete, e të cilat në njëren apo formën tjetër do ti pengonin në procese të cfardollojshme integruese.

Po ashtu përkrahje e BE-së me një asistencë teknike të pavarur profesionale me një fond incidental që do të ndihmonte zbatimin e marrëveshjeve do ta përmirësonte dukshëm procesin dhe zbatueshmërinë dhe do të rriste besimin në të dyja vendet për arritjen e një marrëveshjeje finale e cila do të përmbante edhe njohjen reciproke mes tyre.

Ekzekutim i vullnetit politik të deklaruar të BE-së rreth avancimit të Kosovës dhe materializimit të perspektives së saj evropiane, sidomos me (a) Futjen sa më parë të Kosovës në listë të bardhë të Shengenit në mënyrë që të përfundojë izolimi i padrejtë i qytetarëve; si dhe (b) Të ndikojë te pesë shtetet mosnjohëse të BE-së për një qasje më të hapur dhe kooperuese ndaj Kosovës. Këto masa do ta rrisnin besimin e qytetarëve të Kosovës në integrimin evropian, në procesin e dialogut si dhe do ta bënë atë më të prekshëm dhe përfitues edhe për qytetarët e Kosovës duke ndikuar kështu që të rritet besimi se ky dialog nuk është vetëm për BE dhe Serbinë por edhe për Kosovën dhe qytetrët e saj.

Këta do të ishin disa nga hapat me anë të së cilëve Organizatat Ndërkombetare (Bashkimi Evropian) si dhe aktorë tjerë (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) do ta ndimonin shumë përfundimin me sukses të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.